

04-06-2018

P.nr.2717/17

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues Mustaf Tahiri, me sekretaren juridike Drita Ejupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, P/II.nr.1818-6/17, e dt.26.10.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, më dt. 14.12.2017, mori këtë:

### AKTGJYKIM

**PRANOHET** kërkesa e PTH-së në Ferizaj, P/II.nr.1818-6/17, e dt.26.10.2017, dhe kjo gjykatë lëshon:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### I pandehuri:

[REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit, i lindur më [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### S e p s e:

Me dt.16.08.2017, rreth orës 17:30h, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për Buqësi dhe Pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomik-pyjor Nerodime-Jezerc, në vendin e quajtur "Plenija", me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 2 trungje të llojit ah, me dimensione të gjata boniteti III, me diametër 45-50 cm, gjithsejtë në kubaturë prej 3.31m kub, i ka bartur me traktor të markës Rakovica, vlera e dëmit të shkaktuar është 446.85Euro.

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe nenit 495 par. 1 të KPPRK-së, e gjykon me:

### DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej **200€ (dyqind/euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma të tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1 (një) ditë burg.



Obligohet i pandehuri qe te demtuarës Drejtoria per Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural zyra në Ferizaj, ti kompensoj dëmin ne vlerën prej 446.85€ në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

### *Arsyetimi*

**Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm**, me aktakuzën, P/II.nr.1818-6/17, e dt.26.10.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënien-lëshimin e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke shqyrtuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vlerëson se ka prova të besueshme, lidhur me bazueshmërinë e Aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve dhe erdhi në përfundim se i pandehuri vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata ka obliguar te pandehurin qe te demtuarës Drejtoria per Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural zyra n; Ferizaj, ti kompensoj demin ne vleren prej 446.85€ në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.


Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit është marrë në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**P.nr.2717/17 e dt.14.12.2017**

Sekretarja juridike  
Drita Ejupi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Mustaf Tabiti



#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të njëjtë, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.